



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
PËR VITIN 2021**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

- Duke vlerësuar rolin e institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatimin e drejtë dhe të paanshëm të mbikëqyrjes ligjore për konsolidimin e standardeve në ushtrimin e të drejtave të njeriut;

- Duke vlerësuar kontributin e institucionit në procesin e integritetit evropian të vendit nëpërmjet zbatimit me sukses të Projektit të Binjakëzimit “Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me *acquis* të BE-së për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave”, si dhe në modernizimin e kuadrit ligjor për të drejtën e informimit;

- Duke vlerësuar veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit në zhvillimin me përgjegjshmëri të hetimeve administrative *ex-officio* në lidhje me rastin e cenimit dhe përhapjes së të dhënave personale;

- Duke vlerësuar zgjedhjen e Zyrës së Komisionerit në Komitetin Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) si një mundësi për të nxitur autoritetet publike shqiptare në konsiderimin e transparencës si faktor pozitiv në komunikimin me publikun si mekanizëm për të luftuar korrupsionin,

**Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2021 dhe konstaton se:**

- Ka realizuar plotësisht rekomandimet e adresuara në rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si edhe ato të adresuara nga raporti i progresit për Shqipërinë të Bashkimit Evropian për vitin 2021.

- Ka dhënë kontribut parësor në hartimin e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të përafuar me *acquis* të BE-së dhe projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.9.2014 “Për të drejtën e informimit”.

- Ka konsoliduar procesin e shqyrtimit administrativ të ankesave për dhënien e informacionit/dokumentacionit me karakter publik, aspekt i veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit, e vlerësuar edhe nga partnerë ndërkombëtarë (SIGMA/OECD).

- Ka kryer hetime administrative me fokus monitorimin e programit të transparencës së kategorive të ndryshme të autoriteteve publike, si dhe ka dalë me vendimmarrje konkrete për zbatimin e legjislacionit në këtë fushë.

- Ka kontribuar në shtimin e numrit të autoriteteve publike që kanë instaluar Regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit në portalin pyetshtetin.al (REKPGDI) dhe Sistemin e Menaxhimit të Aplikimit në portalin unik qeveritar e-Albania (AMS) për trajtimin e kërkesave/ankesave online nëpërmjet tyre.

- Ka kryer një veprimtari të gjerë e komplekse në kuadër të hetimeve administrative për rastet e përhapjes së të dhënave personale, duke nxitur marrjen e masave konkrete e të shpejta për garantimin e plotë të të drejtave të qytetarëve.

- Ka kryer monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontrolluesve në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe marketingut të drejtpërdrejtë, të cilët në veprimtarinë e tyre përpunojnë sasi të mëdha të dhënash personale e sensitive, me fokus verifikimin e masave tekniko-organizative në garantimin e një procesi përpunimi të sigurt.

- Ka miratuar një rekomandim unifikues për 15 kontrollues publikë në sektorin e shëndetësisë për marrjen e masave tekniko-organizative, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave gjatë proceseve përpunuese.

- Ka vijuar angazhimin në veprimtari ndërgjegjësuë sipas fushave të përgjegjësisë me autoritete publike, shoqërinë civile, medien dhe grupet e interesit për respektimin e të drejtave të qytetarëve.

- Ka luajtur rol aktiv në marrëdhëniet ndërkombëtare në kuadër të organizmave ku është anëtar, duke synuar zbatimin e praktikave më të mira në të dyja fushat e veprimtarisë.

### **Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Zyra e Komisionerit për vitin 2022, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:**

1. Të përmbyllë hetimin administrativ për publikimin e databazës me të dhënat e pagave të qytetarëve të punësuar në sektorin publik dhe privat, si dhe databazës me të dhënat e targave të automjeteve brenda vitit 2022.

2. Të luajë rol aktiv në përmbylljen e procedurave për modernizimin e kuadrit ligjor.

3. Të vijojë monitorimin dhe mbikëqyrjen proaktive të autoriteteve publike për verifikimin e përditësimit të Programit të Transparencës dhe të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë e tyre.

4. Të mbështesë autoritetet publike në qartësimin e çështjeve mbi interesin publik dhe rastet e kufizimit të dhënies së informacionit, si dhe të nxisë forcimin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit.

5. Të vijojë shtrirjen e instalimit të sistemeve elektronike AMS dhe REKPGDI në sa më shumë autoritete publike.

6. Të monitorojë dhe mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të tyre, veçanërisht Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), duke u shtrirë edhe në sektorë të tjerë si ai i sigurimeve, financiar jobankar, marketing i drejtpërdrejtë, etj.

7. Të angazhohet në monitorimin e vazhdueshëm për zbatimin e masave të lëna në rekomandimet e mëparshme për kontrollues publik e privat.

8. Të angazhohet në krijimin e rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale, diktuar nga përmirësimi i legjislacionit kombëtar të kësaj fushe.

9. Të sigurojë pjesëmarrje aktive në cilësinë e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) dhe vijimin e angazhimit aktiv në organizmat e tjerë ndërkombëtarë ku Zyra e Komisionerit është pjesë.

10. Të angazhohet në bashkëpunimin me qytetarë dhe grupe interesi për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor në të dyja fushat e përgjegjësisë dhe rritjen e ndërgjegjësimit për zbatimin e tij.

Miratuar në datën 28.4.2022